


LLOGARITË VJETORE JOFINANCIARE, SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË

2025*


INSTAT publikon të dhënat përfundimtare të Llogarive Vjetore jofinanciare, sipas Sektorëve Institucionalë, për vitin 2024 dhe ato gjysmëfinale për vitin 2025. Në vitin 2025, vlera e shtuar bruto në terma nominale, u rrit me 4,89 % krahasuar me vitin 2024. Kontributin më të lartë në këtë rritje e ka dhënë Sektori i Familjeve (S.14) me +5,67 pikë përqindje, i ndjekur nga Sektori i Administratës Publike (S13) me +1,75 pikë përqindje dhe Sektori Jo-financiar (S11) me +1,07 pikë përqindje.

FIG. 1 KONTRIBUTI I SEKTORËVE NË RRRITJEN NOMINALE TË VLERËS SË SHTUAR NË PIKË PËRQINDJE, 2025*



Në strukturën e vlerës së shtuar bruto, sektori jo – financiar, zë peshën më të madhe me 45,06%, i ndjekur nga sektori i familjeve me 41,17%.


FIG. 2 STRUKTURA E VLERËS SË SHTUAR BRUTO, SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË, 2024 – 2025*



Në vitin 2025, treguesi “Kompensimi i Punonjësve” zë 33,57 % të vlerës së shtuar bruto, nga 31,74 % që zinte në vitin 2024.


Kompensimi i punonjësve shënoi rritje me 10,09 % në ekonominë gjithsej (S.1), krahasuar me vitin 2024. Sektori Jo-Financiar (S.11) dhe i Administratës Publike (S.13), janë dy sektorët që kanë paguar pjesën më të madhe të kompensimit të punonjësve në ekonominë e vendit përkatësisht 48,18 % dhe 29,55 % të tij.

FIG. 3 KOMPENSIMI I PUNONJËSVE SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË, 2021-2025*




Të ardhurat e disponueshme (B.6g) për familjet u rritën me 5,77 % në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024. Grafiku i mëposhtëm paraqet të ardhurat e disponueshme të familjeve sipas burimit.

FIG. 4 TË ARDHURAT E DISPONUESHME TË FAMILJEVE SIPAS BURIMIT, NË MLN LEKË



Sektori Jofinanciar (S.11) ka investuar 42,7% të vlerës së shtuar, të gjeneruar gjatë vitit 2025 në formimin bruto të kapitalit fiks, krahasuar me 35,8% gjatë vitit 2024.

FIG. 5 NORMA E INVESTIMIT SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË



Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Llogaritë Vjetore jofinanciare sipas Sektorëve Institucionalë](https://www.instat.gov.al/)

Metodologjia

Përshkrimi i Llogarive jofinanciare sipas sektorëve institucionalë

Llogaritë jofinanciare sipas sektorëve institucionalë, pjesë kyçe e llogarive kombëtare, bazohen në standardin ESA 2010 dhe paraqesin transaksionet ekonomike dhe ndërveprimet mes sektorëve, përfshirë lidhjen me ekonominë botërore. Njësitë prodhuese ndahen në pesë sektorë: korporatat jo financiare (S11), korporatat financiare (S12), qeveria e përgjithshme (S13), sektori i familjeve (S14) dhe institucionet jofitimprurëse për familjet (S15). Organizimi dhe regjistrimi i llogarive është i ngjashëm me kontabilitetin e biznesit, ku çdo transaksion regjistrohet në një llogari të veçantë, me balancues që lidh llogaritë mes tyre. Njësitë institucionale janë subjekte autonome me qendër interesi ekonomik në territor dhe janë grupuar në pesë sektorët kryesorë, që përbëjnë ekonominë e përgjithshme, me mundësi ndarje në nënsektorë. Në secilin sektor institucional, njësitë prodhuese grupohen gjithashtu sipas aktiviteteve ekonomike në përputhje me karakterin e aktivitetit të tyre kryesor. Për klasifikimin e çdo njësie prodhuese në një aktivitet ekonomik, përdoret Nomenklatura e Aktivitetit Ekonomik (NVE Rev 2.0).

Llogaritë klasifikohen në "Llogaritë korente" dhe "Llogaritë e Akumulimit".

Llogaritë korente përbëhen nga:

Llogaria e prodhimit,

Llogaria e gjenerimit të të ardhurave;

Llogaria e shpërndarjes parësore të të ardhurave;

Llogaria e shpërndarjes dytësore të të ardhurave;

Llogaria e shpërndarjes së të ardhurave në natyrë;

Llogaria e përdorimit të të ardhurave,

Llogaritë e akumulimit tregojnë, për secilin sektor, ndryshimet në volum dhe vlerë të aseteve dhe detyrimeve. Ato përbëhen nga:

Llogaria e ndryshimit të pasurisë neto nga kursimet dhe transfertat e kapitalit;

Llogaria e blerjes së aktiveve jofinanciare.

Me qëllim harmonizimin dhe mundësinë e krahasueshmërisë, çdo tregues në sistemin e llogarive kodifikohet sipas standardit evropian të llogarive ESA 2010.

S.11 Sektori jo-financiar përfshin njësitë institucionale që veprojnë si subjekte juridike të pavarura, ushtrojnë veprimtari tregtare dhe kanë si funksion parësor prodhimin e mallrave dhe shërbimeve jo-financiare.

S.12 Sektori financiar përbëhet nga njësitë institucionale të cilat janë subjekte juridike të pavarura, ushtrojnë veprimtari tregtare dhe kanë si funksion parësor prodhimin e shërbimeve financiare.

S.13 Sektori i administratës publike përfshin njësitë institucionale që janë prodhuese jotregu, të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime për konsum individual dhe kolektiv, dhe që financohen kryesisht nga pagesat e detyrueshme të mbledhura nga njësitë e sektorëve të tjerë. Ky sektor përfshin gjithashtu njësitë institucionale që merren kryesisht me rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare.

S.14 Sektori i familjeve përfshin individë dhe grupe individësh që veprojnë si konsumatorë, si dhe si sipërmarrës që prodhojnë mallra tregtare dhe shërbime financiare e jofinanciare (si prodhues tregu), me kusht që ky aktivitet të mos kryhet nga njësi të veçanta të trajtuara si kuazi-korporata. Gjithashtu, sektori përfshin individë dhe grupe individësh që prodhojnë mallra dhe shërbime jofinanciare për konsum final vetjak.

S.15 Sektori i Institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve (IJFSHF) përfshin institucione jofitimprurëse që janë njësi të veçanta juridike, të cilat ofrojnë shërbime për familjet dhe veprojnë si prodhues privatë jotregu. Financimi i tyre mbështetet kryesisht në: kontribute vullnetare të dhëna nga familjet, si në të holla ashtu edhe në natyrë, transferata nga administrata publike dhe të ardhura nga pasuritë e tyre.

Përkufizime të variablave

Prodhimi (P1): Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet

në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra

natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

Konsumi ndërmjetës (P2): Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit, Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks.

Konsumi Final (P3): Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo- Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

Konsumi final individual (P31) përfshin Konsumin Final të Familjeve, Konsumin Individual të Qeverisë dhe Konsumin e Institucioneve Jofitimprurëse në shërbim të familjeve, llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Shpenzimet për konsum kolektiv (P32) të qeverisë së përgjithshme përfshijnë shpenzimet e saj për konsum kolektiv sipas funksioneve përkatëse (COFOG). Ato llogariten si diferenca midis shërbimeve gjithsej jo për treg dhe prodhimit jo për treg të shërbimeve për konsum individual.

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (P51): Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve (P52): Përcaktohet si diferenca midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferenca midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (P6) (fob) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (P7) (fob).

Kompensimi i punonjësve (D1) përkufizohet si shpërblimi total, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i paguan punonjësit në këmbim të punës së kryer nga ky i fundit, gjatë periudhës kontabël, Kompensimi i punonjësve përfshin pagat dhe kontributet sociale të punëdhënësve.

Taksat mbi produktet dhe importin (D21): Taksat mbi produktet janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si: Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza dhe taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte dhe importe (D31): Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësitë institucionale rezidente.

Vlera e shtuar bruto (B1G): Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferenca midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

Fitimi Operativ Bruto / Të ardhurat mikse (B2g / B3g) Fitmi Operativ Bruto (B2g) është diferenca që mbetet pas zbritjes nga vlera e shtuar (me çmime bazë) të kompensimit të punonjësve dhe i taksave dhe subvencioneve të tjera në prodhim. Fitimi operativ i të vetëpunësuarve quhet "E ardhur mikse bruto (B3g)", sepse ajo gjithashtu përmban kompensim për punën e personave të vetëpunësuar dhe anëtarët e familjes së tyre.

Të ardhurat kombëtare bruto (B5g) përfshijnë të gjitha të ardhurat e fituara nga banorët dhe bizneset e një vendi, duke përfshirë edhe ato të fituara jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga pasuritë (D4) janë diferenca midis të ardhurave nga pasuria dhe detyrimeve të paguara nga pronësia e aseteve financiare dhe materiale të paproduhuara (tokë, ujëra të brendshme, pyje etj.). Ato përfshijnë interesin (për depozita, obligacione dhe huatë të rregulluara për vlerën e shërbimeve të ndërmjetësimit financiar - FISIM), interesin, qeratë për tokën, dividendët, të ardhura të tjera nga fitimi i shpërndarë dhe të ardhurat e ndërmarrjeve.

Taksat mbi të ardhurat dhe pasurinë (D5) janë taksa mbi të ardhurat dhe fitimet e personave fizikë dhe juridikë dhe përfshijnë gjithashtu taksat mbi interesin, dividendët, fitimet nga baste dhe lotari, si dhe taksat mbi blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme.

Kontributet dhe përfitimet sociale (D6) – përfshin kontributet sociale të detyrueshme dhe vullnetare, përfitimet sociale përveç transfertave sociale në natyrë dhe transfertave sociale në natyrë.

Kontributet sociale neto (D61) – përfshijnë të gjitha pagesat ndaj ofruesve të përfitimeve sociale, kontributet për sigurimin e detyrueshëm social, shëndetësor dhe të sigurimit të aksidenteve, si dhe sigurimin e pensioneve shtesë.

Përfitimet sociale përveç transfertave sociale në natyrë (D62) – përfshijnë përfitimet që rezultojnë nga pjesëmarrja në skemat e sigurimeve sociale të përgjithshme (pensionet, përfitimet nga sigurimi i sëmundjeve, etj), skemat e sigurimit të aksidenteve të detyrueshëm (të paguara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre) dhe skemat e sigurimit të pensioneve shtesë.

Transfertat sociale në natyrë (D63) - transfertat nga qeveria e përgjithshme ose nga institucione jo fitimprurëse që shërbejnë për familjet drejt familjeve.

Transfertat e tjera aktuale (D7) përfshijnë transfertat të tjera të përfituara ose të paguara aktuale si pagesat për sigurime jo jetë, pagesat brenda qeverisë, bashkëpunimin ndërkombëtar aktual dhe transfertat e tjera aktuale.

Rregullimi për ndryshimin në të drejtat e pensionit (D8) është diferenca midis primeve të sigurimit të pritura dhe pensioneve të paguara.

Transferta kapitale për t'u paguar (D9) janë transaksione që rezultojnë në ndryshimin e pronësisë së aseteve materiale, jo-materiale dhe financiare.

Huadhënie neto (+)/huamarrje neto (-) (B9) është vlera që një sektor i caktuar mund të japë hua ose duhet të marrë hua nga një sektor tjetër. Në ekonominë kombëtare, huadhënie neto (+) ose huamarrje (-) është i barabartë me burimet neto që ekonomia e ka vënë në dispozicion ose ka huazuar nga pjesa tjetër e botës.

Llogaritë jofinanciare janë në konsistencë me publikimet vjetore të PBB-së, sipas metodës së prodhimit, shpenzimeve dhe të të ardhurave.

Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përlllogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.

Gjithashtu, në muajin Janar si çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2024.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga **411** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.